




Architectural Report 2016
**UNDERGROUND PUBLIC PARKING
AT SKANDERBEG SQUARE []**
[] PARKIMI PUBLIK NENTOKESOR





Open

Procurement


Albania







Open
Procurement
Alb



Propozimi ynë për të ndërtuar një parkim nëntokësor në sheshin Skenderbej si arsye të pasurimit të aktiviteteve publike të sheshit, nisur nga një multifunksion që do të ketë sheshi Skenderbej dhe objektet që e rrethojnë si Opera, Pallati i Kulturës, Muzeu Historik Kombëtar dhe Teatri i Kukullave objekte publike me kërkesa për rritjen e frekuencimit të tyre nga qytetaret e Tiranës.


Ky parkim është menduar që të shërbejë edhe banorëve në qendër të Tiranës nisur nga mungesa e parkimeve në zonën verë – perëndimore të Sheshit


Parkimi do të rrisë frekuencimin e aktiviteteve tregtare në unazën e vogël të qytetit duke plotësuar një mungesë të vazhdueshme në këtë zonë.

Në krahasim me kërkesën fletëtare të Bashkisë mendojmë që ky parkim të jetë një ambient polifunksional dhe funksion hybrid siç është dhe Sheshi mbi të. Për ky ambient në qendër të Tiranës të mos shërbejë thjeshtë vetëm si ambient parkimi për makina por mundësisht dhe aktivitete të tjera të organizuar nga bashkia e Tiranës. Të tilla aktivitete mund të jenë Farmer Market në ditën e diele, panairë të ndryshme që mund të organizohen në ditë të ndryshme të vitit si ai i Liberit, i Makinave, i Ndërtimit, i Kulinarisë, i Punimeve Artizanale etj.



Open
Procurement
Albania







Open
Procurement
Alb




Parkimi eshte kerkuar te jete I zhvilluar ne dy kate duke mos zbritur ne nivele me te thella pasi do te rritej shume kostoja e ndertimit. Si kerkese e detyres se projektimit eshte vene qe parkimi te kete 300 vende makinash gje e cila eshte realizuar. Jane studiuar disa hape te ndryshme te sistemit te kollonave nisur nga gabaritet e makinave ku nje vend parkimi eshte marre me dimensione 245 cm me 500 cm dhe eshte zgjedhur sistemi me tre poste midis dy kollonave me akse kollonash 810 cm ne te dy drejtimet . Ky aks I madh kollonash jep mundesine e realizimit dhe te funksioneve te tjera qe kemi permendur me lart. Pra po te shikohet nga dimensionet e hapit te kollonave dhe koridoret e levizejes se makinave hapsirat jane te bollshme dhe te mjaftueshme per parkime publike. Siperfaqja totale e ndertimit eshte 9445 m² , ku siperfaqja e njerit kat eshte 7090 m² dhe siperfaqja e ballkonit 2355 m².




Prerja Gjatesore | Longitudinal section AA'

Shkalla | Scale: 1:100



Prerja Terthore | Transversal section BB'





Procurement
Alb




Nisur nga pozicioni i parkimit ne lidhje me Sheshin eshte shfrytezuar mundësia qe te jep pjeresia e sheshit 3% per largimin e ujit per te krijuar nje ambjent me disa nivele ne parkim ,ne menyre qe te kemi sa me pake germime duke i dhene dhe dyshemes se parkimit nje pjeresi 3 % , pra hapsira e parkimit eshte ndare ne dy pjese ne zonen qendrore dy kateshe dhe ate periferike te sheshit nje kateshe

Bazuar ne ndarjen e parkimit ne dy zona pjesa me dy kate eshte me nje lartesi minimale 270 cm dhe pjesa nje kateshe eshte me lartesi minimale 390 cm dysheme tavan

Nisur sa me lart pjesa nje kateshe do te kete lartesi maksimale 580 dhe minimale 390 dhe eshte nje ambjent me dopjo hapsire i cile do te sherbeje per te permbushur aktivitetet e ndryshme qe kemi shpjeguar ne hyrje te ketij relacioni , funksione te cilat kerkojne dhe ambiente me lartesi me te madhe . Pjesa dy kateshe eshte trajtuar si ballkonade e pjeses me dopio lartesi per te pasur nje hapsire te vetme qe shkrihet me te teren .





Plan -2 Parking / Sunday Market